



Pranuar / Dorezuar Pritjen / Primalo Received / Delivered	18 . 07 . 2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSB/K	5274	2023	113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.805/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.805/2023 të datës 02.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Gjilani, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa me numër A.nr.805/2023 e datës 02.06.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 125 të datës 29.05.2023, i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ (tutje ankuesi) i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 02.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.805/2023 të datës 02.06.2023, kundër Vendimit të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me numër protokollit 125 të datës 29.05.2023, për shkak të moskompensimit me para të ditëve të pushimit pa shfytëzuar, mos zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe moszbatimit të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të

Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 12.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4574/2023 të datës 02.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me numër protokollit 125 të datës 29.05.2023; E-maili i datës 29.05.2023 me të cilin ankuesi konfirmon pranimin e vendimit; Njoftimin për dorëheqje me nr.0522 të datës 18.04.2023 nga ankuesi; Vërtetimin me numër protokollit 0524 të datës 18.04.2023 të Drejtorit për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan lidhur me përvojën e punës; Kërkesën e ankuesit nr.0525/23 të datës 18.04.2023 për Ministrinë e Drejtësisë/SHKK; E-mailin e datës 02.05.2023-kërkesë nga ankuesi; e-maili i datës 24.05.2023-kërkesë nga ankuesi; Pliko postare e datës 01.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023 për Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës nga KPMSHCK-ja; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 805/2023 e datës 12.06.2023 nga organi i punësimit për Këshillin; Akt emërimin e datës 10.04.2018; Vendimi me nr.469 i datës 18.04.2023 i lëshuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, E-maili nga A.Demiri për ankuesit i datës 29.05.2023, Përgjigjen në kërkesën me numër protokollit 397 të datës 30.03.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi ka qenë i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën *Zyrtar Ligjor* në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan. I njëjti me datë 18.04.2023 ka paraqit aktin e dorëheqjes nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës me arsyetimin se ankuesi nga data 18.04.2023 fillon punën në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Ankuesi po me datë 18.04.2023 ka parashtruar kërkesë pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues për kompensimin e ditëve të pushimit pushimit vjetor për vitin 2023, në total dhjet (10) ditë. Ndërsa me Vendimin me numër protokollit 125 të datës 29.05.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesit i është njohur e drejta e bartjes së pushimit vjetor të pushimit pushimit gjegjësisht shtatë (7) ditë.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokollit 125 të datës 29.05.2023, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mos kompensimit me para të ditëve të pushimit pushimit pushimit, mos zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe moszbatimit të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë. Me tej thekson se ankuesi nuk mund ti shfrytëzoj ditët e pushimit vjetor të pushimit pushimit në gjykata duke iu referuar nenin 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr.15/2022 për Statusin, Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinën, Transferimin, Trajnimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës së Bashkëpunëtoreve Profesional.

Në kuptim të shqyrtimit të bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e goditur me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti është nxjerr më vërtetim të plotë të gjendjes faktike dhe në pajtim me dispozita e Rregullores (QRK) Nr.07/2022



për Orarin e punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht me nenin 10 paragrafi 12 më të cilin përcaktohet se: ..." 12. Me rastin e ndryshimit të marrëdhënies së punës nga një institucion në institucion tjetër, zyrtari publik fiton të drejtën e bartjes së pushimit vjetor të pashfrytëzuar." Rrejdhimisht referuar këtij përcaktimi ligjor dhe mbështetur në provat e lëndës rezultojnë se ankuesi ka ndryshuar marrëdhënien e punës nga Shërbimi Korrektues në Këshillin Gjyqësor të Kosovës Gjykata Themelore në Gjiilan, andaj edhe lind e drejta e ankuesit për bartje të ditëve të pashfrytëzuar të pushimit vjetor, duke nënkuptuar të të drejtën e shfrytëzimit të ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor në institucionin që ka themeluar marrëdhëniet të re të punës gjegjësisht në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

Kolegji i Këshillit konstaton se nuk ka mbështetje ligjore pretendimi ankimor se drejta e ankuesit për kompensimin në para të ditëve të pashfrytëzuar të pushimit vjetor i takon në mbështetje të nenit 10 paragrafi 10 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, me të cilin është paraparë: "... Përjashtimisht paragrafit 9 të këtij neni, kompensimi në para i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit mund të bëhet në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Në këtë rast, kur institucioni nuk mund të sigurojë shfrytëzimin e ditëve të mbetura të pushimit për zyrtarin publik, i njëjti do të kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Në vlerësimin e Kolegjit aplikimi i këtyre normave ligjore përkatësisht kompensimi në para i ditëve të pashfrytëzuar të pushimit vijnë në shprehje vetëm në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së zyrtarit publik pra në rastin ky zyrtari publik e ndërpret(humb) statusin e zyrtarit publik dhe se institucioni nuk mund të sigurojë shfrytëzimin e ditëve të pushimit të mbetur të zyrtarit publik, e mbi këtë bazë konstatimi dhe duke nisur nga fakti se ankuesi vetëm ka ndryshuar marrëdhënien e punës pa e humbur statusin e zyrtarit publik, pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim në para të ditëve të pashfrytëzuar të pushimit vjetor në Shërbimin Korrektues të Kosovës janë të pabazuara.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.805/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

